



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 223, Datë 16.10.2018**

**MBI**

**MIRATIMIN E “KËRKESAVE MINIMALE PËR ZYRTARIN E PËRPUTHSHMËRISË,  
KRITERET PROFESIONALE SI DHE KRITERET E TJERA PËRZGJEDHËSE” DHE  
MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OST TË  
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 47 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017 “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE” Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST të gazit natyror,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017, ka certifikuar “Operatorin e Kombinuar të Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a..
- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 565 Prot, datë 03.09.2018, ka paraqitur kërkesën për miratimin paraprak të kandidaturës së Zyrtarit të Përputhshmërisë.
- Bordi i ERE me Vendimin nr. 207, datë 27.09.2018 filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST të gazit natyror.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 626 Prot., datë 03.10.2018, ka përcjellë shkresën “Marrje mendimi” pranë MIE dhe Autoritetit të Konkurrencës, për dijani “Albgaz” sh.a., me anë të së cilës ka ftuar institucionet sipërpërmendur të shprehin opinionet apo komentet e tyre mbi këtë vendimmarrje. Vlen të theksojmë se deri më sot nuk ka mbërritur asnjë objeksion apo koment nga palët sipërcituar.
- Gjithashtu ERE me shkresën nr. 623 Prot., datë 02.10.2018, i është drejtuar shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe MIE duke i bërë me dije vendimin e ERE për fillimin e procedurës dhe i ka kërkuar të paraqesë për mriatim në ERE, “Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”, sipas detyrimit që buron nga Programi i Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të

Transmetimit për gazin natyror të miratuar nga me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.

- Sa më sipër Shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 565/3 Prot., datë 10.10.2018, ka përcjellë për miratim “*Kërkesat minimale për Zyrтарin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse*”, si më poshtë:  
**“Kërkesat minimale për Zyrтарin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”**

Kriteret profesionale:

- Personi fizik të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkencat Juridike/Ekonomike; pas një diplome të nivelit Bachelor në shkencat Juridike/Ekonomike.
- Personi Fizik/Juridik me përvojë prej të paktën 5 vjet në shërbime ligjore/ekonomike.

Kërkesat përzgjedhëse:

- Personi/Kompania duhet të ketë aftësi analizuese në çështjet rregullatore, me fokus mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore mbi transparencën, përputhshmërinë e procedurave dhe praktikave konform rregulloreve përkatëse,
- Personi/Kompania nuk duhet të ketë një kontratë shërbimi aktuale me ndonjë subjekt tjetër të angazhuar në sektorin e gazit, përveç operatorit të kombinuar të Albgaz sh.a.
- Personi kandidat nuk duhet të kryejë asnjë detyrë tjetër profesionale dhe nuk duhet të lejohet që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kryejë ndonjë funksion tjetër apo të marrë pjesë në biznes ose të jetë partner biznesi me ndonjë pjesë të kompanisë vertikalisht të integruar ose me shumicën e akioneve të saj, ose me çdo kompani të lidhur në aktivitetin e gazit natyror përveç transmetimit të gazit natyror.

Kriteret Kualifikuese:

- Personi kandidat: Dëshmi penaliteti, vërteim procedimi gjyqësor:
  - Personi kandidat: Kontribute sociale të papaguara, taksa dhe tatime të pa likuiduara;
  - Kompania: Proces falimentimi ose likuidimi.
- ERE ka kompetencë të miratojë Programin e Përputhshmërisë të propozuar nga OST e gazit natyror, në bazë të nenit 47, pika 1 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
  - OST e gazit natyror, nëpërmjet organeve të saj drejtuese ka të drejtë të miratojë Zyrтарin e Përputhshmërisë, pas miratimit paraprak nga ERE, në bazë të nenit 47, pika 2 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
  - ERE ka kompetencën për të miratuar kriteret dhe detyrat për pozicionin e Zyrтарit të Përputhshmërisë, në bazë të nenit 47, pika 3 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
  - Kushtet e kontratës së zyrtarit të pajtueshmërisë janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimmarrjet e ERE-s, në lidhje me operatorin e sistemit të transmetimit të gazit natyror.

- Kontrata e zyrtarit të pajtueshmërisë ka listuar kushtet që duhet të përmbushë zyrtari i pajtueshmërisë dhe që nënshkruhen pas miratimit në ERE të Zyrtarit të Përputhshmërisë.
- Vendimi i Bordit të ERE është objekt rishikimi me kërkesë të palëve të interesuara.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë “Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”.
2. Të miratojë paraprakisht Zyrtarin e Përputhshmërisë së OST të gazit natyror, z. Elvis PONARI.
3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë Albgaz sh.a për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**